

Mbi
Auditimin e Brendshëm
Ushtruar në Drejtorinë Çerdhe e Kopshte

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi të plotë në Drejtorinë Çerdhe e Kopshte– Bashkia Shkodër, për periudhën 01 Janar 2014 – 31 Dhjetor 2017 nga auditimi rezultoi:

III. Permbledhje ekzekutive

Drejtoria Çerdheve dhe Kopshteve - Bashkia Shkodër funksionon si institucion varësie i Bashkisë, me varësi hirarkike nga Drejtoria Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Drejtoria Çështjeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.

Për vitet 2014- 2015 Drejtoria Çerdheve si veprimtari kryesor ka krijuar kushte të përshtatshme për qendrim, akomodim dhe kujdes ndaj fëmijëve . Drejtoria administron 4 çerdhe : “ 1 Qerdhori”, “Perash”, “Manush Alimani” dhe “10 Korriku” .Aktivitetet e çerdheve janë planifikimi, detajimi dhe realizimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e objektit të çerdheve, riparim dhe blerje të paisjeve ,si dhe akomodim dhe trajtimi ushqimor të fëmijëve nga 0 – 3 vjeç. Çerdhet frekuentohen mesatarisht nga 145 fëmijë. Personeli i 4 çerdheve gjithsejt është 57 vete, ndërsa administrata përbëhet nga 3 vete dhe drejtore ,si dhe 4 përgjegjëse ,1 infermiere, 30 kujdestare, 4 kuzhinierë, 2nd/kuzhinierë, 3 roje, 6 sanitare, 4 punonjës me kontrate.

Për vitet 2016 – 2017 drejtorisë çerdheve i ka ndryshuar emertesa, funksioni ,aktivitetet dhe përbërja strukturore bazuar në Urdhërin nr 20 datë 22.01.2016 të Kryetares së Bashkisë “Për transferimin e edukatoreve dhe punonjësve mbështetës të arsimit parashkollor pranë drejtorisë së Çerdheve , Vendim nr 299 datë 23.05.2016 “Për ndryshimin e emertimit të institucionit në varësi të Bashkisë Shkodër nga drejtoria e Çerdheve në “Drejtoria e Çerdhe –Kopshteve” dhe VKB nr 17 datë 28.04.2016 ”Miratimi i buxhetit” ,ku është realizuar emertesa e re drejtoria e Çerdhe – Kopshteve, si dhe VKB NR 605 datë 01.09.2016 dhe VKB nr 205 datë 19.06.2017 “Miratimi i Strukturës Çerdheve dhe Kopshteve”. Drejtoria veprimtari kryesore ka krijuar kushte për qendrim, kujdes dhe edukim të fëmijëve. Kjo drejtori administron 3 çerdhe, deri me datë 30.09.2016 drejtoria ka administruar çerdhen “ 10 Korriku” objekt me qira, si dhe 23 kopshte, të ndarë në 5 kopshte me dreke dhe 18 kopshte pa drekë.

Aktivitetet e çerdheve –kopshteve janë planifikimi , detajimi dhe realizimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen e objekteve të çerdhe - kopshteve, riparim dhe blerje të paisjeve ,si dhe akomodim, trajtim ushqimor dhe edukim të fëmijëve nga grup mosha 0 – 3 vjeç dhe 3 – 6 vjeç.

Përbërja dhe frekuentimi i 4 çerdheve gjithsejt nga 181 foshnje (0 – 3vjeç), personel gjithsejt 58 veta,e ndarë administrata 6 vete ,1 drejtore , 38 kujdestarë dhe shërbime mbështetëse 14veta dhe 4 punonjës zëvendësues.

Përbërja e 23 kopshteve (5 me dreke dhe 18 pa dreke) gjithesejt 726 fëmijë,të ndarë në 436 fëmijë me drekë dhe 290 fëmijë pa drekë, si dhe personeli i kopshteve gjithesejt 172 persona, e përbërë nga 130 edukatore dhe 42 personel sherbimi.

Gjatë auditimit janë konstatuar mangësi në perpilimin e rregullores së brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve punës, nuk ka pershkrime pune,ka mangësi në perpilimin e regjistrit të riskut, nuk ka vlersime pune, nuk është bërë plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në tërren.

GJETJET DHE REKOMANDIMET

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të mëparshëm të auditimit.

Nga auditimi rezultoi se rekomandimet e lëna ne përfundim të angazhimit të mëparshëm të auditimit nuk janë zbatuar plotësisht.

1. **Gjetje.**Referuar neneve 4, 5,11 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,Anekseve të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Drejtoria e Çerdhe –Kopshteve - Bashkia Shkodër, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, përgatitjen e planit vjetor të punës, perpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë dhe listë kontrollet për vizitat në terren, planin kontrollit brendshëm, nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangësi në perpilimin e rregullores së brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve të punës, ka mangësi në perpilimin e regjistrit të riskut, nuk është plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në tërren.

Rekomandime .

a.Pershtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

b. Perpilimin e planit vjetor të punës, përmirësimin e regjistrit riskut, hartimin e plan veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, perpilimin e liste kontrolleve për vizitat në terren.

2.Gjetje Referuar germa “b” pika 4 neni 9 i ligjit 10296 date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” drejtimi duhej të përcaktojë objektivat, në përputhje me objektivat e miratuara nga Titullari Njësisë Publike, për kryerjen e funksioneve të ngarkuara, në rritjen e efektivitetit të aktiviteteve të drejtorise.

3.Gjetje Referuar neneve 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” Drejtoria Çerdhe –Kopshteve duhej të kishte ngritur sistemin e monitorimit, por nga auditimi rezultoi se kjo drejtori nuk ka ngritur sistem monitorimi.

Rekomandime

a. Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të informimit dhe monitorimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efikasitetit të institucioneve çerdhe –kopshte.

b. Të bëhet analiza e realizimit të objektivave të informohet me shkrim Drejtoria Kulture, Arsim,Rini e Sporte, Drejtoria Çështjeve Sociale Strehimit dhe Shendetit Publik si dhe Kryetare e Bashkisë lidhur me aktivitetin e Drejtorise Çerdhe –Kopshteve.

4.Gjetje. Ka mangësi në mbajtjen e dosjeve të personelit, nuk është bërë vlerësim i punës së punonjësve, nuk janë lidhur kontrata me punëmarresin zëvendësues, duke vepruar në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 9761 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të punonjësve, nuk janë përcaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë.

Rekomandim

Plotesimin e dosjeve të punonjësve ,të listuar dhe nënshkruar nga zyra Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse, kryerjen e vlerësimit të punës së punonjësve,kualifikimi i punonjësve me program dhe i dokumentuar.

5.Gjetje. Në referencë të pikës 263,te udhëzimit Nr.02 DT.06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” duhej të ishte përpiluar dhe miratuar gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit, por nga auditimi rezultoi se nuk është bërë përpilimi dhe miratimi i gjurmes së auditit , veprim që ngarkon me përgjegjësi nëpunësin zbatues.

Rekomandim

Të kërkohet me shkrim, prane Drejtorisë Planifikimit buxhetit në Bashki për të marrë asistencën e nevojshme për përpilimin e zbatimit e gjurmës auditit për buxhetin.

6.Gjetje.Në referencë të pikës 2 neni 7 Nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ne fund te vitit ushtrimore duhej ishte bërë kontabilizimi i debitorëve dhe kreditorëve sipas detyrimeve dhe pagesave ne fakt,ndërsa nga auditimi rezultoi se debitorët për secilin vit nuk janë pasqyruar ne pasqyrat financiare vjetore.

Rekomandim .

Të bëhet riverifikimi i të gjithë detyrimeve për vitet 2014-2017 ,si dhe të nxirren të gjithë detyrimet e prapambetura. Ne fund te vitit ushtrimor të bëhet korigjimi në pasqyrat financiare sipas faktit me detyrime debitore dhe kreditore.

Rekomandim. Të plotesohet libri i pagave për vitet 2016-2017 nga nëpunesi zbatues.

7.Gjetje Referuar nenit 12 te ligjit 9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, neni 40 pikat 1 e 8 te VKM 914 date 29.12.2014 “Rregullat prokurimit publik” ,Autoriteti kontraktor është pergjegjës për prokurimin e fondeve, si dhe planifikon në fillim viti natyren,sasitë dhe llojet e kontratave,që do të prokurohen,si dhe në asnjë rast ,proçedura prokurimit me vlere te vogël.

8.Gjetje .Në disa raste të blerjeve është vepruar me protokoll të brendshëm të institucionit,nuk është vepruar rregullisht, me protokoll të veçantë për urdhërat,proçes verbalet,dokumentat e prokurimit dhe shkresat me të tretë ,për prokurimet publike referuar pikës 19/neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2010‘Menaxhimit Financiar’ .

9.Gjetje. “Kërkesat për prokurim’ nuk janë përpiluar nga drejtuesi funksional I institucionit si dhe nuk i është drejtuar nëpunësit autorizues(i dokumentuar dhe protokulluar), veprim që bie në kundërshtim me nenet 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 02 datë 06.02.2012”Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.Drejtuesi i institucionit duhet të sqarojë arsyen e kryerjes së shpenzimit, bashkangjitur specifikimet e mallit ose te shërbimit.

10.Gjetje.Referuar nenit 40 pikes 2 te VKM nr 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ”Ne prokurim Komisioni vlersues i prokurimeve nuk përbehet nga specialiste sipas natyres së blerjes, juristi nuk ploteson saktë dokumentacionin dhe nuk ndjek saktë proçeduren e blerjes.

11.Gjetje .Referuar nenit 40 pikes 3 VKM nr 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ” për blerjet në menyre elektronike,ftesa për ofetë duhet ti drejtohet 5 operatoreve elektronik.

12.Gjetje. Referuar pikës 7 neni 40 i VKM nr nr. 914 dt. 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. fatura tatimore nuk është e nënshkruar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit.

13.Gjetje .Referuar ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar firma fituese nuk ka të përcaktuar në ekstraktin e QKR si operator për kryerjen e punimeve sipas të dhënave të kushteve teknike të objektit të shpenzimit dhe preventivit.

14.Gjetje.Referuar pikës 19/neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2010“Menaxhimit Financiar” , i ndryshuar dhe Urdhërit nr 57 datë 12.06.2014 të Ministrit të Financave”Për gjurmën e auditit për blerjet me vlera të vogla”,në asnjë rast nuk plotësohet gjurma auditit për blerjet.

Rekomandime

a.Kërkesa për shpenzim të përpilohet nga subjekti shpenzues, me analizë shpenzimi,të dërgohet nepërmjete prokollit Drejtorisë për miratim shpenzimi.

b.Te behet trajnimi i komisionit të blerjeve të vogla nga specialistet e Njesise Prokurimit pranë Bashkise.

15.Gjetje. Referuar neneve 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 02 datë 06.02.2012”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.Drejtuesi i institucionit duhet të sqarojë arsyen e kryerjes së shpenzimit, bashkangjitur specifikimet e mallit ose të shërbimit, si dhe të miratojë kërkesat për shpenzim nga drejtuesi i institucionit.

16.Gjetje . Referuar nenit 58 të VKM nr 914 datë 29.12.2014, i ndryshuar, kryetari i komisionit duhet të jetë drejtues, të paktën njëri antar i komisionit vlerësimit ofertave duhet të jenë ekspert fushë, ose të kontraktohet një ekspert i jashtëm,si dhe jo të njëjtit antarë si komisioni i blerjeve me vlerë të vogël.

17.Gjetje .Referuar nenit 23 specifikimet e mallit duhet të bëhen për çdo artikull ushqimor me karakteristika të sakta dhe të japë mundësi të njëjta ofertuesve.

18.Gjetje. Referuar nenit 59 – 62 kontraktuesi duhet të zbatojnë rregullat dhe detyrimet kontraktore,si dhe kontraktori të monitorojë zbatimin e detyrimeve të kontratës.

19.Gjetje .Referuar pikave 34-41 të udhëzimit nr . 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” hyrja e mallrave në magazine duhet të ishte sipas gjendjes fizike të tyre,dhe fletë - hyrja duhet të ishte leshuar nga magazinieri pasi të ishte bërë më parë verifikimi fizik i mallit.Dalja e mallit nga magazina duhet të ishte shoqëruar me urdhërdorëzimi,fletëkërkesë si dhe grafik i shpërndarjes. Malli është lënë në ruajtje tek firma kontraktore dhe administrimi nuk është bërë nga përgjegjësi material.

20.Gjetje .Referuar ligjit nr 9154 datë 6.11.2003 ‘Për arkivat ‘ dosja e tenderit duhet të ishte e inventarizuar dhe arkivuar nga juristi.

Rekomandime

a.Kërkesat dhe Planifikimet për prokurim të perpilohet nga subjekti shpenzues, të dokumentohen ,protokollohen dhe të miratohen nga Autoriteti Kontraktor.

b.Komisioni i vleresimit të ofertave të jetë tjetër nga komisioni blerjeve të vogla, kryetari komisionit të jetë drejtues, të paktën njeri antar specialist fushë.

c. Magazinimi dhe levrimi i mallit të bëhet bazuar në kontratë ,preventiv fitues , grafik të levrimit të mallit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

d . Autoriteti Kontraktor të monitorojë çdo moment zbatimin e detyrimeve kontraktore, bazuar në specifikime dhe grafik levrimit të mallit.

e. Dosja e prokurimit të inventarizohet dhe të arkivohet.

21. Gjetje.Në referencë të pikave 8-10 të udhëzimit NR. 3, DATË 15.2.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të Ndërtimit " periudha e garancisë për punimet zgjat deri në dy vjet nga data e aktit të kolaudimit të punimeve e cila përcaktohet dhe në kontratë,por shuma për garancite e punimeve janë në ruajtje që nga viti 2013.

22.Gjetje.Në referencë të pikës 57 të udhëzimit nr. 30 date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik",hyrja e aktiveve të dhuruara duhet të shoqerohet me Marrveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njesite donatore; Faturën që indentifikon mallrat dhe vlerën e tyre,por nga auditimi rezultoi se aktiveve të dhuruara nuk janë bërë hyrje.

Rekomandime

a. Për të gjitha investimet deri në dy vite të ngrihet komisioni për të bërë vlerësimin e gjendjes së investimeve ,dhe të vazhdohet me procedurat e likuidimit të garancisë së punimeve në bazë të vlerësimit të komisionit.

b.Të ngrihet një komision që të bëjë vlerësimin e aktiveve të dhuruara bazuar në faturat shoqeruese dhe akt/marrveshjeve ,të bëhet hyrje dhe të përfshihen në inventar.

23.Gjetje. Në referencë të pikave 42-50 të udhëzimit nr .30 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik",komisioni i marrjes në dorëzim të mallit duhet të bëjë verifikimin e mallit tek magazina e blerësit,por nga auditimi rezultoi që komisioni ka bërë hyrje mallit pa bërë verifikimin fizik të mallit.

24.Gjetje .Në referencë të pikës 85 germa a,b të udhëzimit nr .30 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik"komisioni i inventarizimit ka përgjegjësi të bëjë verifikimin fizik të mallit si dhe bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që

mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës,por nga auditimi rezultoi që komisioni i inventarizimit ka bërë inventarizimin pa bërë verifikimin fizik të mallit pasi mallin e disponon në ruajtje firma kontraktuar.

25.Gjetje .Specialisti i Drejtorise se Kopshte dhe Çerdheve i cili është i ngarkuar për ndjekjen dhe rakordimin e levizjes së mallrave , duhej të kishte bërë rakordimin e levizjes së mallrave nga magazina për tek kopshtet dhe Çerdhet,duke u bazuar në hyrjet- daljet, urdhër dorezimin, forcen , kartelat e mallrave në magazinë . Nga auditimi i kryer rezultoj se përmbledhëset e daljes së ushqimeve formulohen dhe firmosen vetëm nga magazinieri. Për moskryerjen e rakordimeve mban përgjegjesi Specialiste e ngarkuar për kontrollin e magazinës .

Rekomandime

a. Specialisti i ngarkuar për ndjekjen dhe rakordimin e magazines të bëjë çdo ditë rakordimin e forces ushqimore të raportuar ,kuotës ushqimore dhe daljes së ushqimit nga magazina për tek kopshtet dhe çerdhet,si dhe të nënshkruaj përmbledhësen e daljes së ushqimeve së bashku me magazinierin.

b. Mallrat gjendje në magazine të mbahen të ndara dhe të sistemuara për Kopshtet dhe Çerdhet në ambiente të veçanta.

Njësia Auditimit Brendshëm

Bashkia SHKODËR